



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1743/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI92/20

Parashtrues

Milomirka Tamburić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Milomirka Tamburić (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Hilmi Aliu nga Podujeva.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës specifikisht nuk e konteston kushtetutshmërinë e ndonjë akti të autoritetit publik të Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës, në të vërtetë ka të bëjë me pretendimet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat e saj nga disa individë dhe autoritete publike të Republikës së Kosovës. Nga thelbi i ankesave kuptohet se kërkesa bën fjalë për të drejta pronësore, të cilat garantohen me nenin 46 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 maj 2020, kërkesa u dorëzua (nëpërmjet postës) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 26 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe përfaqësuesin e saj për regjistrimin e kërkesës. Përmes kësaj shkrese parashtrueses së kërkesës iu kërkuar plotësimi i formularit, sqarimi dhe qartësimi i kërkesës dhe bashkëngjitja e dokumentacionit relevant.
8. Më 6 korrik 2020, shërbimi postar njofton Gjykatën se parashtruesja e kërkesës e ka pranuar shkresën e 26 qershorit 2020.
9. Më 21 korrik 2020, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi një shkresë, e cila përveç pretendimeve të përsëritura nuk përmban asnjë dokumentacion relevant.
10. Më 25 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Gjykata rikujton se përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës Hilmi Aliu, më parë në cilësinë e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë kishte dorëzuar kërkesat

e bashkuara KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, të cilat më 20 nëntor 2020 u refuzuan nga Gjykata me procedurë të shkurtër, në pajtueshmëri me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.

12. Faktet e rastit janë tejet të përgjithësuara dhe të natyrave të ndryshme për nga objekti i kontestuar, ku përshkruhen disa individë lidhur me një kontratë shitblerjeje, nga e cila thuhet se parashtruesja e kërkesës është mashtruar dhe vënë në lajthitje. Gjithashtu kërkesa përmban elemente të pretendimeve që përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës i kishte përmendur në kërkesat e sipërcekura.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesja e kërkesës pretendon se asaj i është bërë e padrejtë nga individë dhe autoritete publike të Republikës së Kosovës, në lidhje me një kontratë shitblerjeje, rreth një paluajtshmërie (ngastre) vendndodhja e së cilës është në Podujevë, e cila pretendohet të jetë shfrytëzuar nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, z. Hilmi Aliu nga Podujeva.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

16. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

17. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti i referohet nenit 22, paragrafit (4) të Ligjit, që përcakton:

“Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...).”

18. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], nënregullin (2) shkronja (h) dhe rregullin 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], nënregullin (5) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

32 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

35 (5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, (...).”

19. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se asaj dhe përfaqësuesit të saj i është bërë e padrejtë nga disa individë rreth kontratës së shitblerjes dhe më pas nga autoritetet publike përkitazi me të drejtat e saj pronësore, siç garantohen me nenin 46 të Kushtetutës.
20. Në zbatim të dispozitave të lartpërmendura, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë as faktet e rastit dhe as pretendimet e parashtrueses së kërkesës, për shkak se kërkesa është e paplotë, e paqartë dhe se asaj nuk i janë bashkëngjitur dokumentet relevante apo aktet e kontestuara. (shih, ngjashëm Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin K103/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21, si dhe rastin K107/16, parashtrues *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).
21. Gjykata, më 26 qershor 2020, njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe përfaqësuesin e saj për regjistrimin e kërkesës dhe nga të njëjtit kërkoi: “Në lidhje me kërkesën tuaj, Gjykata ju njofton se për të shqyrtuar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi/ja në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese e ka për detyrim

ta sqarojë kërkesën e tij/saj. Për më tepër, duhet të plotësoni formularin e kërkesës dhe të cekni saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendoni se u janë cenuar, cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin e kontestoni dhe të bashkëngjitni vendimin e kontestuar së bashku me vendimet e tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë kërkesë. Formularin dhe sqarimet e kërkuara mund t'i dorëzoni në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të kësaj shkrese”.

22. Gjykata vëren se më 21 korrik 2020, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës në Gjykatë ka dorëzuar një shkresë, e cila shpreh ankesat e përsëritura ndaj individëve dhe autoriteteve publike të caktuara. Megjithatë edhe përkundër kërkesës së Gjykatës, që në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga pranimi i shkresës, të plotësohej dhe qartësohej kërkesa, dhe t'i bashkëngjiteshin informatat dhe dokumentacioni relevant, një gjë e tillë nuk është bërë.
23. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë sa më efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, të njëjtat i deklaron si të paqarta dhe të paplota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës. (Shih, rastet e Gjykatës, KI89/18, parashtrues: *Agim Jashari*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29; KI74/18, parashtrues: *Gëzim Murati*, Vendimi për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26; KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, parashtrues: *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 33; dhe KI90/20, parashtrues: *Arben Boletini*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 25 nëntorit 2020, paragrafi 25).
24. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret formale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë.
25. Andaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit, me rregullin 32 (2) (h) dhe me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20, 22.4 dhe 48 të Ligjit, të rregullave 32 (2) (h) e 35 (5) të Rregullores së punës, më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi